



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 04 Maj 2021

Nr: 51

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 29, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 30.04.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 04.05.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO - Relator
Elvis ÇEFA - Anëtar
Ilijan RUSMALI - Anëtar
Koli BELE - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Anëtarët e KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 29, të anëtarëve të KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 313, datë 26.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër”.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Ankuesit, anëtarët e KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër kanë depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 29 regj., datë 30.04.2021.

Në mbledhjen e datës 04.05.2021, ora 13:50, pas relatimit të z. Elvin Lako u konstatua se kërkesa ankimore nr. 29 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17 pika 3, shkronja “a” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, Kërkesa Ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17 pika 3, shkronjat “a” e 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”,

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 29, datë 30.04.2021, të paraqitur nga anëtarët e KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 05 Maj 2021, në orën 13:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Elvin LAKO - **Relator**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Illirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**

